



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:169890

Datë: 21.11.2024

Numri i dokumentit: 06486688

KPPP.nr. 950/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Distribuum me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me nr. të biznesit 810799364 dhe seli në Prishtinë, kundër debitorit S.L., me nr. unik identifikues ... dhe me seli në Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bahrije Shatrolli Mehmeti, avokate nga Podujeva, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 209/24, i lejuar me datë 15.05.2024 nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj me zyre në Prishtinë, jashtë seancës me datë 21.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit S.L. me seli në Podujevë ashtu që ANULOHET Urdhri përbarimor P.nr. 209/24 i datës 15.05.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj dhe procedura në këtë çështje përbarimore PËRFUNDOHET.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 104.00, (njëqind e katër euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Kosovare për Distribuum me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), mbi bazën e ekstraktit të verifikuar nga librat afarist nr. 58 / 2018 - 7 ka lejuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 209/24 të datës 15.05.2024, me të cilin është urdhëruar debitori S.L., që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit

t'ia paguaj shumën prej EUR 310.34, me kamatë ligjore, nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbarimit me arsyetim se borxhi të cilin e kërkon kreditori është i parashkruar në kuptim të nenit 360, par. 1.5 të LMD-së, si dhe bazuar në nenin 355, par. 1 të po të njëjtit ligj, ashtu që ka kaluar afati ligjor brenda të cilit kreditori ka mund të kërkojë borxhin. Duke qenë se urdhri për përmbarim është lejuar në kundërshtim me nenin 71, pika 1.4 të LPP-së, si dhe borxhi i kërkuar me propozimin për përmbarim është parashkruar, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se i njëjti ka qenë i informuar lidhur me detyrimet ndaj kreditorit dhe të cilat nuk i ka përmbushur. Ka shtuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarimor ka tipare të përmbarueshmërisë, në përputhje me nenin 29, par. 3 të LPP-së, ndërsa nga ekstrakti vërtetohet fakti se debitori ka realizuar pagesa, me ç'rast me pagesa vullnetare është bërë pranimi i borxhit, i cili ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit. I ka propozuar gjykatës që urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke ju referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim:

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e borxhit që kërkohet nga kreditori në këtë çështje përmbarimore, gjykata iu referua nenit 355.1 të LMD-së me të cilin përcaktohet se *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Në kuptim të rregullimit ligjor të lartcekur, e duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat e përfshira në ekstrakt në shumën prej EUR 310.34 janë bërë të arritshme përgjatë periudhës kohore nga data 31.05.2017 deri me

datën 04.10.2018, ndërsa propozimi për përmbarrim nga kreditori është paraqitur me datë 15.05.2024. Kësisoj, gjykata erdhi në përfundim se borxhi sipas ekstraktit afarist të lartcekur ka arritur parashkrimin kjo meqenëse propozimi për përmbarrim nga kreditori është paraqitur pas më shumë se pesë (5) vite nga koha kur kërkesa më e vonshme ndaj debitorit është bërë e arritshme për pagesë.

Nga të lartcekurat, Gjykata gjeti se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 të LPP-së, i cili përcakton se: “...*prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarrues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve*” andaj u vendos që urdhri përmbarrimor P.nr. 209/24 i datës 15.05.2024 të anulohet.

Vendimin mbi përfundimin e procedurës përmbarrimore, Gjykata e mbështeti në nenin 66.3 të LPP-së i cili përcakton se “*Përmbarrimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarrim*”.

Pretendimet e kreditorit se debitori ka bërë pagesa të pjesshme e rrjedhimisht ka ndërprerë afatin e parashkrimit gjykata i vlerësoi të jenë pa ndikim në vendosjen ndryshe si nga dispozitivi i këtij aktvendimi. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që nga ekstrakti afarist kontestues, rezulton se pagesa e fundit e debitorit për kreditorin është bërë me datë 04.10.2018 andaj edhe sikur kjo pagesë të llogaritet si pohim i tërësishëm i borxhit nga debitori, prapëseprapë, afati i parashkrimit ka rifilluar ditën e nesërme pas kësaj pagese, pra me datë 05.10.2018, kjo në mbështetje të nenit 373 par.3 të LMD-së i cili parasheh se “*Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi) meqenëse afati i parashkrimit të borxhit të debitorit*”.

Për rrjedhojë, rezulton se prej pagesës së fundit të debitorit më 05.10.2018 e deri në inicimin e propozimit për përmbarrim me datë 15.05.2024 përsëri kanë kaluar mbi tre (3) vite, andaj edhe borxhi nga ekstrakti afarist përsëri ka arritur afatin e parashkrimit nga neni 355 i LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarrimore, gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet përfaqësuesit të debitorit në emër të prapësimi të ushtruar në shumë prej EUR 104.00, konform rregullores në fuqi për tarifatat e avokatëve.

Andaj, në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 950/24, datë 21.11.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.